

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

Faleminderit, zonja Zhupa, që me jepni mundësinë të shpreh disa konsiderata në lidhje me çështjet që ngritët! Në përgjithësi ju i ndiqni me shumë vëmendje zhvillimet në fushën e arsimit dhe në Ministrinë e Arsimit, por, me sa duket, kësaj here ju paskan shpëtuar disa ngjarje! Për shembull që në datën 22 gusht në Ministrinë e Arsimit kemi zhvilluar një takim me rektorët dhe administratorët e universiteteve, madje bashkë edhe me ministren e Financave, pikërisht për çështjen e pagave të pedagogëve, por edhe për çështje të tjera financiare. Mund ta verifikoni edhe nga rrjetet sociale të MAS-së, por edhe të MFE-së. Kemi diskutuar gjatë, i kemi vlerësuar të gjitha alternativat.

Ndërkohë, nesër kemi një takim me përfaqësuesit e Sindikatës së Punonjësve të Universiteteve, pikërisht ata që kanë firmosur petitionin. Edhe këtë mund ta verifikoni. Nesër në orën 15:00 kemi takim në Ministrinë e Arsimit bashkë me ata, sigurisht, për të diskutuar të njëjtën çështje. Ndërkohë që vetëm për dialogun për universitetet nuk mund të na akuzoni. Nëse ka pasur dialog më intensiv me universitetet, kjo ka ndodhur pikërisht gjatë vitit të fundit, kur kemi ngritur edhe Komitetin për Politikën e Arsimit të Lartë. Çdo muaj takohemi me rektorët e universiteteve, me një pjesë të kabinetit qeveritar, që lidhet me fusha të caktuara, ku është vetë Kryeministri. Aty sigurisht që diskutojmë e marrim vendime bashkërisht për çështje që lidhen me arsimin e lartë.

Nuk ka pasur asnjëherë një periudhë, qoftë kur kanë qeverisur qeveritë e majta apo të djathta, që të ketë një dialog kaq intensiv, qeveria të jetë kaq e përfshirë dhe marrëdhënia me universitetet të jetë edhe produktive, sepse shumë nga vendimet që kemi marrë, sigurisht, i kemi marrë bashkë me ta. Se çfarë vendimesh do të marrim, nuk mund t'ju them që tani, e rëndësishme është që tani e kemi këtë çështje në vëmendje. E konsiderojmë shumë të rëndësishme dhe në varësi të shumë faktorëve që lidhen me situatën ekonomike. Sigurisht, ne do të kemi një vendimmarrje. Ndërkohë që na akuzoni për mungesë mbështetjeje studentore, a

ka pasur ndonjëherë në të gjitha këto vite bursa për studentët, të cilat janë sa paga minimale, 340 mijë lekë?!

Tani që rritet edhe paga minimale, të gjithë ata studentë që zgjedhin lëndë prioritare, ata studentë që janë ekselentë, që fitojnë olimpiada, do të përfitojnë edhe përjashtim nga tarifa, do të përfitojnë bursë studimi sa paga minimale. Ndërkohë që bursat që lidhen me paktin për universitetin vazhdojnë të jenë në fuqi për të gjithë ata studentë që kanë mesatare mbi 9, për të gjithë ata studentë, që vijnë nga shtresa të caktuara që kanë nevoja, vijnë nga familje me ndihmë ekonomike apo që kanë aftësi të kufizuara e kështu me radhë. Ndërkohë që përmende se nuk isha radhën e kaluar. Po, nuk isha javën e kaluar, sepse mora pjesë në samitin global të arsimit në Nju Jork.

Meqë përmende mungesën time, kam qenë atje dhe dua t'ju sjell në vëmendje se një nga konkluzionet më të rëndësishme të atij samiti ishte se ka një nevojë urgjente për transformimin e arsimit kudo në botë, pikërisht për të përballuar krizat, qoftë krizën aktuale ekonomike, por edhe zhvillimet e tjera, ndryshimet klimatike apo ndryshimin e teknologjisë. Ajo për të cilën të gjithë përfaqësuesit e shteteve ramë dakord, ishte: "Arsimi duhet të jetë sektori, ku të gjitha palët duhet të solidarizohen, duhet të bashkëpunojnë". Në qoftë se ka një sektor ku ne duhet të jemi bashkë, ky duhet të jetë arsimi. Arsimi duhet të na bashkojë, jo të na ndajë. Në fakt, ne jemi të hapur për bashkëpunim. E kemi shtrirë dorën e bashkëpunimit. Mund t'ju sjell rastin më të fundit, pra kongresin tregtar të arsimit.

I kemi sjellë ftesë Komisionit të Arsimit. Ju e keni refuzuar ftesën. Fillimisht e keni pranuar pastaj që të gjithë, i kam të gjitha të dokumentuara, e-mail-et tuaja, ku keni refuzuar ftesën tonë për të qenë edhe ju pjesë e këtij kongresi. Ishte një mundësi shumë e mirë që të ndanim mendimet tona, të na jepnit sugjerimet tuaja. E përsëris edhe një herë se jemi shumë të hapur, por jo me akuza, jo me baltë, pa fakte, sepse kjo është ajo që bëni çdo ditë. Arsimi nuk duhet të jetë kjo formë politike. Në arsim duhet të bashkëpunojmë. Madje kemi edhe ligjin e arsimit parauniversitar në konsultim publik, që shumë shpejt do të vijë në parlament. Këtu jo vetëm unë, por Ministria e Arsimit dhe e gjithë qeveria jemi të hapur dhe presim sugjerimet tuaja se si ta përmirësojmë këtë ligj, si ta bëjmë akoma më të mirë.

Ndërkohë, edhe një çështje më ka bërë shumë përshtypje, për të theksuar pikërisht këtë çështjen e bashkëpunimit, në ditën e parë të shkollës, në datën 12 shtator, shumë prej jush, në vend që të uronin nxënësit, mësuesit, postimi që kanë bërë në rrjetet sociale ka qenë një dëshpërim i jashtëzakonshëm: “Kjo shkollë është në kushte mjerane, këtu nuk bëhet mësim”. Ky ishte urimi që u jepni ju nxënësve?! Ky është motivimi që u jepni ju mësuesve?! Të paktën vetëm një ditë në vit ju duhej të ishit pozitivë; ju duhej t’i motivonit mësuesit; ju duhej t’i inkurajonit nxënësit, sepse fillojnë një rrugëtim të bukur, që është rrugëtimi i dijes. 365 ditët përdorini për akuza, sa të doni, por dita e parë e shkollës duhej të ishte dita kur duhej të ishit pozitivë dhe konstruktivë.

Kam edhe shumë çështje të tjera, por, e dashur Ina, të pres që herë tjetër, kur bëjmë aktivitete dhe kur kemi ngjarje që lidhen me arsimin, të mos e refuzosh ftesën, por të jesh konstruktive.